

NJOFTIM

PËR AKTIVITETET E FORMIMIT TË REGJISTRIT TË ADRESËS

Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive të Formimit të Regjistrit të Adresës, do të fillojë me përmbledhje në terren të të dhënave grafike dhe atributive për rrugë dhe numra shtëpish, në funksion të vendosjes të Regjistrit Grafik të Rrugëve dhe Numrave të Shtëpive në Komunën e Petrovecit

Agjencia e Kadastrës të Patundshmërive, vazhdon me aktivitetet për vendosjen e Regjistrit Grafik të Rrugëve dhe Numrave të Shtëpive, i cili është bazë për formimin e Regjistrit të Adresës në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Aktivitetet e terrenit do t'i zbatojë Shoqëria e Matjes së Tokave, Inxhiniering dhe Tregti "Geofoto Zenit inxhinjering" SHA, në bazë të kontratës së nënshkruar për mbledhje të të dhënave në terren për 21 komuna, ndër të cilat është edhe Komuna e Petrovecit.

Me mbledhjen e të dhënave në terren për rrugët dhe numrat e shtëpive, do të grumbullohen të dhëna hapësinore dhe përshkuese për rrugët dhe numrat e shtëpive në vend dhe do të fitohet pasqyrë e qartë se cila rrugë ku ndodhet dhe cilët numra të shtëpive i referohen asaj, si dhe cilin vendbanim.

Mbledhja e të dhënave në terren për rrugët dhe numrat e shtëpive do të realizohet në këtë periudhë:

- **Nga 21.5.2021 deri më 4.6.2021 – Komuna e Petrovecit (vendet e banimit si Badar, Bllacë, Breznicë, Konjare e Epërme, Gradmancë, Divlje, Konjare e Poshtme, Katllanovë, Kozhle, Letevcë, Ognjancë, Petrovec, Rëzhaniçinë, Konjare e Mesme, Sushicë, Qojlijë dhe Çiflig);**

Gjatë kryerjes së aktiviteteve në terren, gjeometërit e autorizuar, do të mbajnë legjitimacion përkatës të identifikimit. I lusim qytetarët, që t'i presin mirë në realizimin e informatave të nevojshme dhe të mundësojnë fotografim të objekteve.

Nga Regjistri i vendosur i Adresave përfitime do të kenë të gjitha institucionet shtetërore dhe të gjithë personat fizikë dhe juridikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Me atë do të mundësohet mënyrë e shpejtë dhe e lehtë e kërkimit dhe identifikimit të rrugëve, ndërtesave dhe banesave në hapësirë, do të thjeshtësohen dhe shkurtohen afatet e vendosjes së rrugëve të reja dhe do të sigurohet saktësia e të dhënave.